



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:137888

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05393748

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.. K.. për shkak të veprës penale sulm seksual nga neni 229 par. 3 nen par 3.4 lidhur me par 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II-nr.1640/20 të datës 27.10.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 24.01.2024 dhe 26.01.2024 të mbyllur për publikun, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku, të akuzuarit A.. K.. dhe mbrojtësit të tij av. Salih Mekaj sipas autorizimit dhe mbrojtësit të viktimave Luan Mehmetaj, me date 30.01.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datës 29.02.2024 përpiloi këtë:

A K G J Y K I M

I akuzuari:

A.. K.., i lindur me datën në fshatin B..... – P., nga i ati S.. dhe e ëma Sh.., e vajzërisë H.., i martuar, me profesion Hotelier, ka të kryer shkollën e mesme, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, posedon numër të telefonit, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e paraburgimit nga data 12.10.2020 deri me dt. 10.11.2020 dhe arrestit shtëpiak nga data 10.11.2020 deri me dt. 10.12.2020, mbrohet në liri.

Në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së,

L I R O H E T N G A A K U Z A

Sepse:

Me datën 12.10.2020 rreth orës 03:00, në fshatin R.. e A.. – R.. K.. e P., pikërisht në villën e tij, me dashje përmes kanosjes së atëçastshme për rrezikim të jetës dhe duke shfrytëzuar situatën ku viktima ka qenë e pambrojtur, e cili të njëjtën që ta prek me qëllim seksual pa pëlqimin e saj, dhe atë të dëmtuarën A.. (M.. P..) M., në atë mënyrë që: e dëmtuara dhe i dashuri i saj kishin ardhur për vizitë në Pejë dhe kishin rezervuar dhomë hosteli në shtëpinë e të pandehurit dhe pas arritjes në Pejë ata takohen me të pandehurin në qytet, shkojnë në lokal G.. L.. ku qëndrojnë të tre së bashku deri pas orës 01:00 dhe aty viktima fillon një fjalosje me të dashurin e saj dhe dalin dhe shkojnë në shtëpi – hostel, ku i dashuri largohet me veturë ndërsa viktima mbetet me të

pandehurin i cili e merr me veturën e tipit S.. me targa ..-.-.. dhe e dërgon viktimën në vilën e tij në zonën malore ku përmes thikës duke e kanosur të dëmtuarën se do ti shkaktojë lëndime e cyt të njëjtën që ta prek në organe gjenitale dhe tenton që të këtë marrëdhënie seksuale.

- **me çka kishte për të te kryer veprën penale sulmi seksual nga neni 229 par 3 nën-par 3.4 lidhur me par 1 të KPRK-së.**

E dëmtuara A.. M.. shtetase F.. e përfaqësuar nga zyra për mbrojtën e viktimave në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civilë.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

ARSYETIM

1.Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve.

Prokuroria Themelore në Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 24.09.2020 ka ngritur aktakuzë PP.nr.1640/20 ndaj të akuzuar A.. K., për shkak të veprës penale sulmi seksual nga neni 229 par 3 nën par 3.10 pika 3.10.2 te KPRK-së

Me datën me datë 24.01.2024 dhe 26.01.2024 gjykata ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësorë të mbyllur për publikun në prezencë të Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku, të akuzuarit A.. K. dhe mbrojtësit te tij av. Salih Mekaj sipas autorizimit dhe mbrojtësit të viktimave Luan Mehmeta

Prokurori Shtetit Dorjan Juniku, në fjalën e tij përfundimtare të dhënë ne shqyrtimin gjyqësor drejtpërsëdrejti ne procesverbal ka deklaruar se: përtej dyshimit mirë te bazuar se këtu i akuzuari A.. K.. është kryes i veprës penale për te cilën akuzohet dhe këtë konkludim e mbështesim ne fakte si ne vijim:

Nga deklarata e te dëmtuarës A.. M.. dhen ne stacionin policor ne Pejë dhe ne procedurën e mundësisë hetuese te veçantë u vërtetua se e dëmtuara shtetase Franceze kishte vendosur qe se bashku me te dashurinë e saj këtu dëshmitarin F.. D.. te vizitonin Republikën Kosovës ku fillimisht kishin arritur ne Prishtinë nga ku edhe përmes Bokingut kishin bere rezervime ne një bujtinë e quajtur urban Hostel – Bujtin e qytetit me pronar këtu i akuzuari A..K..

Me datën 11.10.2020 e dëmtuara dhe dëshmitari ne fjalë kishin vendosur qe te vinin ne Peje ku me këtë rast i akuzuari A.. K.. e kishte kontaktuar dhe e kishte propozuar qe ti takonte ne lokalin G.. B.. ne P.. dhe për çudi me këtë rast i akuzuari kishte vendosur qe te prezantohej me një emër te rrem si A.. dhe jo A... A thua a nënkupton kjo se i njëjti duke e ditur se veç kishte planifikuar planin e tij dhe qëllimet e tij ne raportet me te dëmtuarën, ne këtë mënyrë kishte provuar qe te manipulonte identitetin e tij. E dëmtuara dhe dëshmitari pasi qe ishin takuar këtu me te akuzuarin kishin shkuar ne Bar dhe kishin konsumuar disa gota alkool ku me pastaj kishin ndërruar vendin duke shkuar ne një restorant, ku ne orët e mbrëmjes e dëmtuara dhe i dashuri i saj kishin pasur një mos marrëveshje e te cilën këtu i akuzuari e kishte shfrytëzuar si karrem te mirë për te arritur qëllimin e tij ashtu qe kishte filluar te tregohej mëshirues me te dëmtuarën dhe dukej sikur donet

ta ngushëllonte ku e dëmtuara ketë rrethanë e duke u nisur nga pastërtia e saj njerëzore e kishte marr ketë veprim te akuzuarit për simpati dhe qellim te keq ne fillim.

Ne fund te mbrëmjes e dëmtuar dhe i dashuri i saj se bashku me te akuzuarin largohen me veturën e tyre te marr me çera e ku me ta ishte edhe këtu i akuzuari. Pas mosmarrëveshjes mes te dëmtuarës dhe te dashurit te saj ky i fundit kishte vendosur qe ta linte ne hotel dhe te kthehej ne P.. ose ne F.. dhe ishte pikërisht ky momenti i art për: A.. i cili mu ne këtë moment ju kishte treguar për një vend dhe pasi qe arritën dëshmitari ne fjalë largohet menjëherë me makinë ndërsa te dëmtuarën e le te vetëm me valigjet e saj me këtu të akuzuarin, i cili edhe për kundër faktit se rezervimin e kishte bërë ne bujtinën e qytetit e jo ne bujtinat ne malet e R..., i kishte propozuar te dëmtuarës qe te enjten ta dërgonte ne bujtinat ne R.. e duke e ditur se njëjta ishte e apasionuar pas bjeshkëve, andaj duke i besuar këtu te akuzuarit kishte pranuar qe te shkoj ne bjeshkë ku me te arritur me te dal nga qyteti i Pejës dhe me tu futur ne pjesën e grykës se R.. i akuzuari kishte filluar qe te realizoj qëllimin e tij dhe planin e tij te menduar paraprakisht, ashtu qe kishte filluar te marr iniciativë duke tentuar qe te dëmtuarën ta puthte, donet tja vinte dorën mbi këmbë,. Tija mbante dorën ku e dëmtuara kishte filluar menjëherë ta refuzoj duke i thënë se nuk donte mirëpo e pa fuqishme dhe pa mbrojtur kishte filluar ta kuptonte se situata po i shpëtonte nga kontrolli dhe kishte filluar te mendonte se si te dilte nga ajo situatë ashtu që kishte filluar dialogun dhe diplomacinë duke u munduar qe mos ta bënte nervoz te akuzuarin duke i thënë se kishte nevojë për kohe etj, sepse kjo ngjarje ja kishte përkujtuar skemat e filmave horror dhe kishte mësuar se si duhet te sillej me personat e tillë ne ato momente. Pasi arritën tek bujtinat i akuzuari e kishte njoftuar se familja e tij posedon 4 bujtina secila larg njëra tjetrës 10 metra , ku e dëmtuar dhe i akuzuari hyn ne një nga këto bujtina druri ku i akuzuari menjëherë e shërbej me disa birra, ku e dëmtuara ne ato momente kishte tentuar fshehtazi ta njoftonte përmes telefonit te dashurin e saj por nuk fatkeqësisht nuk kishte pas rrjet, përderisa i akuzuari vazhdonte te insistonte ne gjeste e tij, ne fjalët e tij ku e dëmtuara ja kishte ber me dije se ndihej e pa këndshme, ku ne atë moment i kishte thënë vetes se kishte ber një gabim dhe donte te kthej ne qytet dhe prej atij momenti e njëjta i vuri vetes një qellim dhe vendosi te ikte nga i akuzuari, i cili ne vazhdimësi vazhdonte ta puthte, ta përkëdhelte dhe pasi e njëjta kishte refuzuar i akuzuari duke i dhen vetes te drejt absolute sikur e dëmtuara ishte fajtores për gjithë ngjarjen qe po ndodhte, i kishte thënë te njëjtës mos bej shaka me mua dhe duke i thënë se nëse dëshiron te kthehej në qytet do te duhet te bej marrëdhënie me te, mirëpo e dëmtuara stresohet gjithnjë me tepër ndërsa i akuzuari me një gjakftohtësi vazhdonte te insistonte ne kërkesat e tij, përderisa e dëmtuara gjatë gjithë kohës po shikonte ku ishin çelësat, shikonte dritaret dhe siç thotë ajo : mund te ikja nëse doja e te vrapoja ne pyll ose mund ta godisja ne kokë e ti merrja çelësat por problemi ishte se nuk e dinte fare ku ishin valigjet e saj e një fakt e dinte vetëm i akuzuari, prandaj duke mos pasur zgjidhje tjetër e dëmtuara duhej te vazhdonte te rrinte e te përpiquej te bej pazarllëk me te akuzuarin qe tja kthej ne qytet se bashku me valigjet e saj.

Gjate mbrëmjes e dëmtuara kishte tentuar ta hapte derën por ajo ishte ende e mbyllur madje edhe kishte provuar qe ta hapte derën ku ne atë momenti akuzuari i kishte thënë qe te mos bej ndonjë gjë te marr se do te behej keq dhe për te argumentuar gatishmërinë e tij për ti ber keq te dëmtuarës, nxjerr një thikë te gjepit nga pantallonat e tij duke e detyruar disa here te dëmtuarën qe te kishte marrëdhënie seksuale me te, përpiquej ta prekte, tija merrte dorën te dëmtuarës për ta përkuar te akuzuarin ne organet gjenitale te tij, ku e dëmtuar e kishte shtyre ne këtë moment

mirëpo i akuzuari veç kishte arritur ta detyroj që ajo ta bënte ketë të fundit pra e kishte prekur ne organet gjinitale. Ishte ora 22:20 kure e dëmtuara dhe i akuzuari ishin nisur për ne qytet ku i njëjti e kishte len te priste ne një vend buzë rruge për 2 min duke i thënë se po shkonte që ti merrte valigjet e saj i cili me pas u kthye me valigje ne veturë dhe i kishte thënë se e kishte par F.. ku edhe pse dëmtuar kishte kërkuar që ta kthente atje i akuzuari e kishte refuzuar. Duke qen insistuese që ti shpëtonte kësaj ngjarje te tmerrshme, e dëmtuara kishte përfituar nga rasti kur i pandehuri ishte ndal për tu furnizuar me derivate ne një pompë te benzinës ku fatmirësisht i njëjti kishte len çelësat e veturës brenda saj ashtu që e dëmtuara nga ulësja e saj kërcen ne ulësen e drejtuesit te shoferit, ndez veturën dhe me vrull largohet nga aty.

Nga deklarata e dëshmitarit F.. D.. u vërtetua se pasi i njëjti e kishte len te vetëm të dëmturen nuk ishte larguar për ne F.. ashtu e fillimisht kishte tentuar thirrte te dëmtuarën A.. mirëpo nuk kishte pas mbushje ku edhe ishte kthyer para hotelit dhe aty deri ka ora 08:00 -08:30 dëshmitari kishte par një fqinje dhe kishte pyetur çka po pret dhe i cili i kishte treguar se po e priste te akuzuarin ku ne oborr te hotelit kishte par një zonje me fëmijë dhe i kishte kërkuar që te ja thërras te pandehurin ku kjo zonje kishte shkuar dhe e kishte ftuar bashkëshorten e te akuzuarit, te cilës dëshmitari i kishte shpjeguar bashkëshortes se tij problemin e tij e cila me ka dëgjuar ngjarjen e kishte kontaktuar këtu te pandehurin – bashkëshortin e saj mirëpo i njëjti nuk i ishte përgjigjur me pas ja kishte dhen numrin A.. mirëpo as ajo nuk kishte qasje në rrjet. Pasi që bashkëshortja e te akuzuarit ishte njoftuar nga dëshmitari ne fjalë se A.. ishte e dashura e tij e njëjta 3 here radhazi ju kishte drejtuar dëshmitarit me fjalët: ‘burri im me te dashurën tende’. Athua pse këtu bashkëshortja e te akuzuarit ju kishte drejtuar ne ketë mënyrë 3 here radhazi dëshmitarit, a nënkupton kjo se e njëjta duke e ditur se këtu i akuzuari bashkëshorti i saj edhe me çka kishte vepruar ne te njëjtën mënyrë edhe me par ndaj turistëve tjerë te shtetasve te huaj, me ketë veprim qartë kishte shprehur friken e saj se çfarë mund ti ndodhte A.. e që pasi që ishin takuar dëshmitari F.. e kishte kuptuar se çfar kishte ndodhur kur e dëmtuara e frikësuar dhe duke pasur prioritete largimin nga këtu i kishte thënë: me ka kthyer ne një te burgosur, ku pasi dëshmitari e pyet se mos te ka dhunuar, e dëmtuara e frikësuar ne palcë i thotë te dashur te saj te tregoj me vonë por eja shumë shpejt. I nderuar gjyqtar ju njoftoj se me datën 21.06.2023 ne prokurorin themelore ne Pejë kemi pranuar kallëzimin penal me nr. te rastit 2023-DA902, i parashtruar kundër te akuzuarit A.. K.. për veprën penale ngacmim seksual ne raport me shtetasen nga shteti i M.. me emrin S.. B.. ku ndaj te njetes kishte vepruar ne te njëjtën mënyrë, andaj ngase u tha me lartë mbes ne tersi pran aktakuzës dhe kualifikimit juridik te saj ashtu që nga gjykata kërkoj që te akuzuarin ta shpall fajtor ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj ne paguarjen e shpenzimeve te procedurë penale, ndërsa, me rastin e përcaktimit te llojit dhe lartësisë se dënimit, ne kuptim te dispozitave ligjore te nenin 70 par 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.13 te KPRK-së, si rrethane renduese te vlerësoj shkallën e lart te pjesëmarrjes se te akuzuarit ne kryerjen e veprës penale ngase i akuzuari paraprakisht gjithçka kishte planifikuar, ne vazhdimësi kishte ngacmuar seksualisht te dëmtuarën, shkallën e larat te dashjes ne kryerjen e veprës penale, ngase i njëjti ka qen i vetëdijshëm se me veprimet e tij do te kryej vepër penale dhe e ka dashur që veprën ta kryej si dhe faktin se njëjti edhe me par ka qen dhe është i pandehur për vepra te njëjta penale, prandaj kërkoj që këtu ndaj te akuzuarit e me qellim te risocializimit te tij, integritimit te tij, ti shqiptoni një dënim me te ashpër.

Mbrojtësi i viktimave Arta Muhaxheri Gjevukaj në fjalën e tijë përfundimtare ka deklaruar:

e mbështes ne tersi fjalën prokurorit te shtetit me qen se pala e dëmtuar është shtetase e huaj dhe kontakti me te nuk ka qen i mundur ne mënyrë te saj kërkojmë kompensim demi.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.. K.. av. Salih Mekaj në fjalën e tijë përfundimtare drejtpërsëdrejti në procesverbal ka deklaruar se: e kam përgatit fjalën time përfundimtare ne formë te shkruar e cila do te jetë pjesë përbërëse e shkresave te lendes dhe nuk e kam ndërmend te zgjatem shumë nga së edhe rasti si rasti nuk është kompleks dhe nuk ka shumë prova dhe nuk ka çka te thuhet shumë. Me gjitha te para se te filloj fjalën time përfundimtare dua ti them tri çështje parimore te cilat duhen respektuar gjate fjalës përfundimtare nga te gjitha palët. Konkretisht e kam fjalën për detyrimin prokurorit qe ne përputhje me nenin 7 par 2 te KPPRK-së, ta bej vlerësimin e provave qe vërtetojnë ekzistimin veprës penale dhe kryesit te saj ne mënyrë objektive profesionale dhe paanshëm. Ne vend te kësaj prokurori përmes citimit fjala për fjalët të citimit të deklaratës të te dëmtuarës duke e veshur me dramacitet dhe emocione te cilat e ka pas te pamundur ti përjetoj kështu si i shfaq qy prokuror i dha vetes te drejt qe te gjykoj edhe për emocionet e bashkëshortes se te akuzuarit se si është ndier ajo ne një moment te caktuar kur dëshmitari i ka thënë se qy është se bashku me te dëmtuarën, këto nuk kanë te bëjnë as me vërtetimin fakteve as me rrethanat e kryerjes, as me përgjegjësin penale te pandehurit sepse ky mund te gjykohet për veprimet te cilat i ka kryer dhe jo për ato qe prokurori supozon se ka pas ndërmend, ka planifikuar apo dhe ka ndier i pandehuri apo paramenduar. Është hera e parë qe ne karrierën time e dëgjoj kaq shumë interpretime subjektive te dëshmimeve te dëshmitareve te cilat pa dyshim nuk i shërbejnë gjetjes se te vërtetës, besoj se kjo gjykatë do ti vlerësoj me objektivitet dhe me profesionalizëm te gjitha provat qe janë administruar këtu pa un ndikuar këtu nga emocionet, pa u ndikuar nga skenari imagjinar qe u inskenuan sot këtu, ndërsa pjesën tjetër të fjalës përfundimtare mbrojtësi i të pandehurit e ka elaboruar verbalisht.

I akuzuari A.. K.. në fjalën përfundimtare të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: e përkrahi ne tersi fjalën e mbrojtësit tim, duke shtuar se ato çka i tha prokurori janë fjalë te cilat as gjysmën tyre nuk i ka thënë e dëmtuara, ndërsa sa i përket emrit A.. atë emër e kam qe 8 vite dhe te njëjtin ma kanë qit ketë te jashtmit si pseudonim dhe nuk është e ndaluar qe te kem një pseudonim apo emër te dytë, ndërsa sa i përket te kaluarës penale kam qen një here i dënuar me gjobë me 500 euro ngase ne atë kohë e kam pranuar fajësinë ngase ne gjykatë me kanë thënë prano se nuk është kurrëgjë ma mirë me pranim fajësisë, ndërsa sa i përket kësaj qeshje penale e gjitha është trillim nga e dëmtuara sepse kur e ka marr vesh se shoku i saj nuk kishte shkuar ne F.. për t'ju arsyetua atij se me mua vetëm ka dal dhe nuk ka pas diçka me shumë i ka tregu gjitha këto për shkak qe ajo me dal e pastër tek shoku apo dashnori i saj, ngase 3 raste i ka pas kur ka qen vetëm nga 15min dha ka mundur te largohet por siç e thash ka reaguar vetëm kur e ka marr vesh se dashnori i saj ishte në P...

2. Konstatimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi këtë gjendje faktike: nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale sulmi seksual nga neni 229 par. 3 nën. par 3.4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

3. Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të drejte të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësorë me propozimin e Prokurorit dhe aprovimin e gjykatës pa ndonjë kundërshtim nga palët në shqyrtim gjyqësor është lexuar dëshmia e të dëmtuarës A.. M.. dhe dëshmitarit F.. D.. të dhëna në Gjykatën Themelore në Pejë me datë 19.10.2020 sipas mundësisë hetuese te veçantë

Ndërsa nga provat materiale të propozuara nga palët janë administruar ne shqyrtim gjyqësorë: raporti i oficerit H.. O.. #3393, i datës 12.10.2020, raport i përpiluar nga zyrtari policor S.. H.. #8975, i datës 12.10.2020, raporti i policit A.. Sh.. #9016, i datës 12.10.2020, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin A.. K., i dhënë pranë stacionit policor në Pejë me datën 12.10.2020, procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin A.. (M.. P..) M., i dhënë pranë stacionit policor në Pejë me datën 12.10.2020, procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitarin F.. D., i dhënë pranë stacionit policor në Pejë me datën 12.10.2020;

Kundërshtim ndaj këtyre provave ka paraqitur mbrojtësi i te pandehurit av. Salih Mekaj i cili ka deklaruar se: raportet e policeve i kam kundërshtuar edhe ne rastin e paraqitjes se kundërshtimit te aktakuzës, si dhe deklaratës se te dëmtuarës dhe dëshmitarit F.. sepse raportet policore nuk u shërbejnë si prova për vërtetimin e fakteve qe kanë te bëjnë me kryerjen e veprës dhe kryesinë saj, ato janë raporte qe tregojnë për veprime te caktuara hetimore dhe vet për veti nuk paraqesin prova.

3.1. Deklaratat e dëshmitareve

3.1.1 E dëmtuara A.. M.. gjatë dhënies se dëshmisë sipas mundësisë hetuese te veçantë të dhënë në Gjykatën Themelore në Pejë me datë 19.01.2020 ka deklaruar se: është e vërtetë se kam dhënë deklarata ne Polici, duke shtuar se para se me ardhë ne Pejë disa ditë kam qëndruar ne P., pasi kam caktuar termin ne një lokal në Peje jemi takuar me te pandehurin dhe dëshmitarin F.. D., është e vërtet se kemi pas mosmarrëveshje me F... dhe me neve ishte edhe i pandehuri,; ne atë lokal kam vazhduar me ndejte edhe disa ore dhe pastaj kam dal nga ai lokal, *F.. është ndal me ble cigare dhe pastaj kemi vazhduar me shkuar ne një lokal qe e ka ditur këtu i pandehuri. Ne kemi vazhduar mosmarrëveshjen me F.. ne lokal dhe kam menduar qe i pandehuri po qëndron me neve pasi qe unë nuk jam ndjere mire, pas asaj fjalosje. F.. është hidhëruar, ka dal nga lokali, kjo ka ndodh para hostelit. F.. është larguar dhe unë kam mbet ne lokal. Mandej i pandehuri me ka propozuar qe nëse done me dal me pa një bjeshke te bukur, dhe unë jam nis me te pandehurin, e kam lënë bagazhin ne kopshte te hostelit, pasi qe kam menduar se i pandehuri do te me dërgoj ne një vend me te mire. Gjate rrugës unë kuptova qe secilën here e me tepër i pandehuri është duke dashtë me përfituar prej meje. Pastaj kam filluar me shikuar telefonin, mirëpo nuk ka pas rrjet dhe kam filluar te shqetësohem, mandej kane filluar lëvizjet, ka filluar te me prek dorën, dhe ma ka qit dorën në këmbë dhe kam filluar te stresohem. Kur kemi shkuar ne shtëpi malore ka tentuar te me prek ne organe gjenitale. I pandehuri ka kërkuar qe ta prek në organe gjenitale, por unë kam refuzuar, kam filluar te qaj. I pandehuri me ka detyruar ta prek ne organe gjenitale dhe për këtë me ka kërcënuar, pastaj ka filluar te mi heq robat me dhune. Unë kam kërkuar te kthehem ne arsye, por i pandehuri ka refuzuar te më ktheje. Kur kam kërkuar te dal nga shtëpia,*

i pandehuri e ka mbyll derën me qelës dhe e ka *nxjerr një thike nga gjepi* dhe me ka thënë se jam një person i keq dhe mund të beje gjëra të këqija. E ka marr çelësin dhe e ka fut në gjep që unë mos të dal. *Me kujtohet se ka qene ora 3 e mëngjesit kur jemi nis me shkuar ne bjeshke.* I pandehuri gjate tere natës ka provuar që të kemi marrëdhënie. Ne ora 10 e 30 te mëngjesit jemi nis nga bjeshka për ne Peje, dhe i kam thënë që me duhet të ju lajmërohem prindërve. Kam kërkuar që ta marr bagazhin tim dhe nuk e disha se kush është në hostel. I pandehuri *një here është ndal ne bankë* dhe unë kam qene se bashku me te, kam dal nga vetura se bashku me te. Jemi nis nga banka dhe unë e kam kërkuar bagazhin. Unë kam kërkuar që të shkoj ta takoj F.. ne Hostel, mirëpo i pandehuri ka kundërshtuar dhe me ka thënë jo. Pastaj kam shkuar prap me veture me te pandehurin dhe kam filluar të nervozohem dhe të ndjej panik. I pandehuri është ndal në një stacion të servisit dhe i ka lënë çelësat në kontakte dhe aty e kam pa rastin për me ik. Kam kaluar nga vendi i pasagjerit në vendin e shoferit dhe kam marr veturën për me dal nga qyteti. Kam zbrit nga vetura dhe e kam sheh veturën dhe e kam thirr F.. me ardh me me kërkuar. Në servis ka njerëz që e kanë parë dhe e kanë lajmëruar policin, ku jam ndal në livadhe ka pa një person i cili ka qenë Polic dhe ka kërkuar nga unë që të prezantohem.

Tutje dëshmitarja në pyetje të mbrojtës ke deklaruar se: mosmarrëveshja ka ndodhur në lokal. Pastaj unë, F.. dhe i pandehuri kemi shkuar me ble cigare, duke shtuar se nuk kam mundur ta njoftoni policinë menjëherë si e kam vërejtur se i pandehuri po me ngacmon nga se nuk kam pas qasje, nuk kam pas mundësi. Në bankë nuk kam hyrë brenda me te pandehurin. I pandehuri ka shkuar vetë me marr bagazhin, kur i pandehuri ka hyrë në bank unë kam mundur me iki, por unë kam pas nevojë ta marr bagazhin, e po ashtu edhe kur i pandehur ka shkuar me marr bagazhin e dëmtuara ka deklaruar se qëllimi im ka qene vetëm ta marr bagazhin, unë nuk kam trilluar asgjë

Tutje dëshmitarja në pyetje të gjykatës ka deklaruar se: se me te pandehurin kemi komikuar në gjuhen angleze, dhe e kam kuptuar mire, edhe i pandehuri me ka kuptuar mire. Arsye pse shkuam në R.. me te pandehurin është se me ka propozuar i pandehuri dhe kam menduar që është diçka me bukur dhe kam shkuar, miro shkak ka qenë edhe mosmarrëveshja me F.., i pandehuri në dhomë ka qëndruar ter kohen, pastaj me Polici kam shkuar në vendin e ngjarjes dhe kam mundur ta identifikoj dhomën, aty dhoma ka qene e mbushur me persona të tjerë, por kur unë kam shkuar me te pandehurin, para identifikimit nuk ka qene askush,

Në deklaratën e dhënë në Polici me datë 12.08.2020 e dëmtuara kishte deklaruar pos tjerash se: edhe në kohen sa kam qenë në R.. kam mundur të ikja, ta goditja me shishe në koke, mirëpo kisha valigjet poshtë.

3.1.2. Dëshmitari F.. D.. gjatë dhënies së dëshmisë sipas mundësisë hetuese të veçantë të dhënë në Gjykatën Themelore në Pejë me datë 19.01.2020 ka deklaruar se: në Pejë kemi ardhur në ora 17:20, ka qenë 11.10.2020, e diele. Me A.. jemi ndalë *ne një kafiteri*, dhe kemi kontaktuar pronarin e hotelit dhe ai na ka propozuar me shkuar *ne një lokal, për çka* në kemi pranuar. Nuk me kujtohet sakte sa ka qene por përafërsisht ka qene ora 20:00, kur ka ardhur i pandehuri dhe është prezantuar dhe na ka thënë se është pronar i hotelit. E ka marr një gote dhe ka filluar me diskutu tema të ndryshme dhe diskutimi ka qenë interesante. Na ka shpjeguar se çka ka në Pejë, mandej unë kam filluar me diskutu me A.., mandej e kam pi nga një gote me te pandehurin. *Pastaj lokali është mbyllë, dhe i pandehuri na ka thënë se mundeni me shku me ble birra ne*

pompe te benzines. Pastaj kemi marr një taksì, kemi arrite ne pompe te benzines, e ka blere birrën dhe jemi kthyer prap ne lokal me pi birrën. Unë kam diskutu gjithmonë e me tepër me A.. dhe ne një moment jam ngrite dhe unë i kam thënë se unë po shkoj ne hotel dhe po largohem nga lokali. Për këtë arsye jam ngrite dhe kam shkuar te vetura, nuk e kam dit sakte se ku është vetura, dhe kur ka ardh vetura e kame pa A.. se është duke me prite dhe i pandehuri ka qenë me larg. Pastaj kemi hype ne veture dhe kemi shkuar ne hotel. Ne veture kam biseduar me A.. dhe kur kemi shkuar para hotelit, i kam thënë A.. rri ti ne hotel dhe unë po shkoj ne F... Kur me ka pa se po nisem është befasuar, unë jam nise dhe jam larguar ne 5 metra largësi dhe kam prit te qetësohem dhe me pak se 5 minuta kane qene kur e kam pa veturën e te pandehurit që me ka kaluar përpara dhe kam menduar se ka ardh me me kërkuar. Pastaj kam prit 30 minuta, jam kthyer ne hotel dhe vetura e te pandehurit nuk është kthyer. Kam hy ne veturën time, me duket se kam prit një ore, jam kthyer ne hotel dhe prap nuk ka qene vetura. Pastaj prape jam kthyer ne veturën time dhe kam fjete me pak se një orë, jam zgjuar dhe jam kthyer prapë ne hotel dhe nuk ka pas as një njëri. Kam shkuar prape te vetura ime e kam marr dhe jam kthyer para hotelit. Kam provuar me thirre A.., mirëpo nuk kam pas mbushje, kam prit aty deri ka ora 08:00-08:30 dhe e kam pa një fqinje qe me ka pyetur se ka po pret dhe i kam treguar se po e pres këtu te pandehurin dhe ai me ka thënë se e thërras unë dhe vjen për 30 minuta. Unë e kam prit por i pandehuri nuk ka ardh. Né oborr te hotelit e kam pa një zonje me fëmije dhe i kam kërkuar te me thërras te pandehurin dhe ajo zonja ka shkuar dhe e ka kërkuar bashkëshorten e pronarit, la kam shpjeguar bashkëshortes se te pandehurit problemin tim dhe bashkëshortja e te pandehurit ka provuar ta thërras prape te pandehurin. Kjo ka ndodhur te hënën ne mëngjes, pra te nesërmen. Bashkëshortja e ka thirre ne tel. Te pandehurin por i. njëjti nuk është përgjigjur dhe unë ja kam jap numrin e A.. që ta thërras A.., mirëpo nuk ka pas qasje. Unë i kam treguar bashkëshortes se këtu te pandehurit se unë kam ardhur me një shoke dhe ajo me ka pyetur se a është ajo dashnorja jote dhe unë i kam thënë se po është e dashura ime dhe ajo 3 here me radhe me ka thënë Burri im me te dashurën tende. Pastaj unë kam menduar se ka pasur aksident dhe unë e kam pyetur a mos ka pasur ndonjë aksident qe me thirre policinë dhe bashkëshortja e te pandehurit me ka thënë se a mundeni me marr veturën time dhe me shkuar ne bjeshke, unë i kam thënë se mundem, dhe ajo me ka pyetur se a e din se ku janë i pandehuri dhe e dashura ime, unë i kam thënë se nuk e di. Bashkëshortja e te pandehurit ka biseduar me dike ne telefon por nuk e di me këndë ka biseduar. Nga mesi i ditës ka arrit i pandehuri dhe me ka pyetur se a e kam kaluar natën mire, dhe unë e kam pyetur se ku është A..dhe i pandehuri me ka thënë se është duke e pire një kafe dhe vjen për 5 minuta. Pastaj është nise me veture shpejte dhe pastaj unë me veturën time jam nisë mi shkuar pas por njëjti ka shkuar me larg. Ne drejtimin tjetër është shkuar edhe bashkëshortja e te pandehurit. Pastaj me ka telefonuar djali i këtu te pandehurit dhe me ka thënë se e dashura ime është ne oborr dhe kërkon te takohet me juve dhe me ka thënë qe te vi shpejt dhe e ka ndale telefonin.

Pastaj e kam thirre djalin e te pandehurit ne telefon por telefoni ka qene i fikur. ***Nder kohe A.. ka thirre ne telefonin e djalit te te pandehurit,*** dhe pastaj me ka thirre prap djali i te pandehurit dhe me ka thënë se A.. ju kërkon, dhe A.. ne telefon me ka thënë se unë arrita me ike dhe me kërkoi qe te shkoj sa ma shpejte dhe me ka thënë se jam te pompa e benzinës Shell. E kam kërkuar ne gps lokaline dhe gps me ka dhënë distancën 30 km. Mandej e kam kërkuar pompën e benzinës Shell, mirëpo pompa Shell kishte shume dhe unë kam shkuar ne 2 apo 3 pompa te benzines Shell dhe mandej A.. me ka thirre dhe unë e ka pyetur se ku është a është ne P.. apo

është me larg, dhe A.. me ka thënë se është përafërsisht 10 minuta larg. Unë i kam thënë se sipas gps janë 30 km, dhe kam shkuar ne një lokal A.. ne K.., mirëpo aty nuk ka pas pompe te benzines Shell, pastaj jam thyer prap ne P., A.. me ka thirre prape dhe me ka thënë se është ne polici dhe se me duhet te shkoj ne polici.

Tutje dëshmitari ne pyetje të Prokurorit ka deklaruar; deri sa kam qenë duke biseduar me bashkëshorten e te pandehurit ka ardhë A.. me gjip 4 x4 dhe na ka thënë, e dëmtuara vjen për 5 minuta, e ka marr bagazhin e te dëmtuarës dhe unë i kam kërkuar qe te shkoj me veture dhe i pandehuri me ka thënë se jo nuk ka vend, e dëmtuara ne telefon me ka thënë se me ka kthyer ne je te burgosur, dhe unë e kam pyetur se a mos te ka dhunuar dhe A.. ka qenë shume ne panik, me ka thënë te tregoj me vone por eja shume shpejte.

Ne deklaratën e dhënë në Polici me datë 12.08.2020 dëshmitari kishte deklaruar pos tjerash se: pasi jemi kthyer ne bujtin ne orën 03:00 te mëngjesit i thash të dashurës sime se po kthena ne F.., ajo me kërkoj të rrija por duke qeni i nervozuar, unë u nisa dhe e pash te dashurën time shumë të befasuar, kam vozitur 100 metra jam parkuar jo larg bujtinës dhe pas 5 minuta e pash veturën 4x4 te pronarit të bujtinës duke kaluar pas veturës sime të parkuar, thash me vete se ishin duke me kërkuar, ndërsa kur ka kontaktuar me te dëmtuarën për mes telefonit dëshmitari ka thënë ajo nuk me është përgjigjur ne pyetjen se çfarë i kishte bërë i pandehuri.

3.2 Provat materiale

3.2.1. Nga raporti i oficerit H.. O.. #3393, i datës 12.10.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se: se dëmtuar me gjepin e të pandehurit ka hyrë ne rrugicën e tij me shpejtësi dhe i ishte ndal mbas shpije dhe pasi i ishte prezantuar se H.. O.. është zyrtar policorë e dëmtuara i kishte prezantuar pasaportën ndërsa për veture i kishte thënë është histori e gjatës sepse kam pasur problem të madhe dhe veturën e kam vjedh, fakte këto të cilat nuk janë kontestuese mirëpo nga ky raport gjykata nuk ka mundur të vërtetoj ndonjë element të veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri.

3.2.2. Nga Raporti i përpiluar nga zyrtari policor S.. H.. #8975, i datës 12.10.2020 gjykata ka vërtetuar çështjen me rendësi se: e dëmtuara A.. dhe dëshmitari D.. me rastin e dhënies së deklaratës ne polici të njëjti vetë e kanë shkruar deklaratën, ndërsa me pas është thirru i pandehuri A.. për mes telefonit i cili i është përgjigjur thirrjes ku është marrë një deklaratë me shkrim, pastaj është bere identifikimi i te pandehuri për mes tetë fotografive, pasta patrulla ka shkuar ne vendin e ngjarës ku është bërë edhe fotografimi i vendit të ngjarjes, fakte këto të cilat nuk janë kontestuese mirëpo nga ky raport gjykata nuk ka mundur të vërtetoj ndonjë element të veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri.

3.2.3 Nga Raporti i policit A.. Sh.. #9016, i datës 12.10.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se: patrulla ka shkuar ne lokacionin afër shtëpisë së zyrtarit policor H.. O.. pas njoftimin nga ana e tij, lidhur me rastin janë njoftuar hetimet rajonale dhe pritet qe te merren me rastin, fakte këto të cilat nuk janë kontestuese mirëpo nga ky raport gjykata nuk ka mundur të vërtetoj ndonjë element të veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, nga ky

3.3 Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari A.. K.. në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor, në mes tjerash ka thënë se: unë jam shkuar në lokalitetin në G., gjate nejtës aty ata janë fjalos mes veti dhe kishin probleme, pasi që janë fjalos here pas here aj djali eshët largu dhe pastaj e dëmtuara me tha a mundesh mëme që në Rugovë du me ndejt 1 javë ose 10 ditë edhe pse ora ishte gati 1 e mesnatës, dy tre here mu ka lut, dhe vendosa për me që, e pasi kemi shkua unë kam flejt në katin e parë kurse e dëmtuara në katin e dytë, nesërmen mëngjes diku nga ora 08:00 jemi kthye për me ardhë në P.. sepse ka dashtë me i ble disa gjera ushqimore sepse ka dashtë me qëndruar në Rugovë 1 jav apo 10 ditë, pasi kemi mbërrir në Pejë jemi ndal në tri vende deri sa kemi arrit deri të shtëpia ime për të marr ajo koferrat, aty në mëngjes kishte ardhë shoku i saj dhe me pyeti ku është shoqja ime unë i thash se ajo është në rrugë në largësi 200-300 metra larg shtëpisë duke me prit për tija që koferrat, pastaj koferin e saj e kam qit në veturë dhe kam shkua tek e dëmtuara dhe i kam thënë se aj shoku yt kishte ardh tek shtëpia duke të prit, pastaj jemi nisur kah V.. për me shkua me pir nga një kafe dhe pastaj me shkua në vetëshërbim me i ble sendet dhe me shkua në Rugovë, tek pasi i kam treguar për shokun e tij se ja ka ardh tek shtëpia hyra me marr një kafe në pompë të benzinës dhe njëjtë sikur herëve të tjera pa e dituar se çka o ka donë mu zi unë i lash qelsat në gjip sikur herëve tjera kur jam dal gjipi nuk ishte aty, nuk dita se çka oshte ba e mora dhe e thirra policin dhe i tregova se me hupi gjipi dhe nuk e di se çka u bë, pastaj pas dy orëve me thirri policia me treguan se ku është gjipi dhe me than hajde me jep deklaratë, pastaj kam jep deklaratë në polici, në lokalitetin kemi qëndruar diku 3- 4 orë dhe kemi konsumuar alkool, unë kam pir me pak ndërsa ata dy me shumë, kur është largu F.. nuk me ka treguar se ku po shkon, por e di që në anglisht të dëmtuarës i ka thënë shkova dhe ja ka bër disa sharje në gjuhën angleze. Për me shkua në Rugovë ka qenë kërkesa e të dëmtuarës veturën deri atje e kam vozit unë, pasi kemi shkua në vilë, e dëmtuara i ka pir dy ose tre birra, unë nuk kam kërkua diçka nga e dëmtuar që të kemi marrëdhënie intime apo të ngjashme dhe as nuk ka pas diskutim.

Tutje i pandehuri ka deklaruar se në P.. kemi mbërrir në orën 07:30 ose 08:00 dhe kemi mrrir në Pejë diku ka ora 09:00, jem ndal tek bankomati i bankës NLB tek shtëpia e kulturës me tërheq, veturën e kam në rrug para shtëpisë se kulturës që është afër jazit, asaj i kam treguar qëllim pse po shkoj tek banka, pastaj i pandehuri dhe e dëmtuara kanë shkua tek shkua tek hosteli – shtëpia e të pandehurit dhe e dëmtuarën e ka len 200- 300 metra larg ngase ka menduar se po e sheh shoku i vet F.. D., të dëmtuarën e kam lëndë në keme dhe unë kam shkua mi marr koferin të dëmtuarës. *Kur i tregova se e pava shoqëruesin tënd (F..) reagoj disi si e trishtuar dhe kishte ndryshime në fytyrë, me pas kemi shkua tek pompa e V.. tek rrethi rruga për R.., aty nuk pim kafe ngase aparati nuk punojte dhe se unë kam ble veç cigare, pastaj veç kur nuk e kam pa gjipin aty dhe e kam thirr policin dhe, gjipin e kanë gjet policia dika ka R...*

4.Elementet e veprës penale

Në nenin 229 par 1 të KPRK-së, është parashikuar se veprën penale të sulmit seksual e kryen: kushdo që prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cjt personin e tillë të prek kryesin apo personin tjetër për qëllim seksual pa pëlqimin e personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim prej një (1) vite.

Ndërsa par. 3 nën-par 3.4 i po të njëjti nenë ka përcaktuar se: Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet: dhe atë kryesi përdor ose kanos se do të përdor armë apo mjet të rrezikshëm

5. Faktet jo kontestuese.

Për gjykatën pas administrimit të provave nuk është kontestuese fakti se e dëmtuara dhe i dashuri i saj kishin ardhur për vizitë në P..ë dhe kishin rezervuar dhomë hosteli në shtëpinë e të pandehurit dhe pas arritjes në P.. janë takuar me të pandehurin në qytet, kanë shkuar në lokalin G.. L.. dhe kanë qëndruar të tre së bashku deri pas orës 01:00, me pas e dëmtuara është fjalosur me të dashurin e saj F.. D.. dhe me pas që të tre kanë shkuar tek hosteli, miro aty i kishte thënë F.. të dëmtuarës se po niset për F.. dhe me pas e dëmtuara dhe i pandehuri janë nisur për ne fsh. R.. e A. R.. dhe kanë qëndruar së bashku deri ne mëngjes rreth orës 10:20 kur janë nisur për qytet.

6. Faktet Kontestuese.

Kontestuese për gjykatën deri në përfundim të shqyrtim gjyqësorë ishte fakti nëse i pandehuri përmes thikës e kanosur të dëmtuarën se do ti shkaktojë lëndime, duke cyt të njëjtën që ta prek në organe gjenitale dhe nëse ka tentuar që të këtë marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën.

Mirëpo gjatë shqyrtimi gjyqësorë nuk është vërtetuar me asnjë prove materiale nëse i akuzuari se paku kishte poseduar thikë me veti natën kritike dhe po ashtu me asnjë provë personale nuk është vërtetuar nëse i akuzuari natën kritike e ka cyt te dëmtuarën që ta prek në organe gjenitale dhe nëse ka tentuar që të këtë marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën.

7. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata pas administrimit të provave, analizimit të tyre me shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim për lirim të akuzuarit nga aktakuza , për shkak se me provat të cilat janë administruar nuk mund të mbështetet as dyshimi i bazuar mirë në drejtim të elementeve të veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari me aktakuzë.

Në përshkrimin faktik te aktakuzës thuhet se: i pandehuri e merr me veturën e tipit S.. me targa dhe e dërgon viktimën në vilën e tij në zonën malore.

Po ashtu nga përshkrimin faktik te aktakuzës thuhet se: përmes thikës duke e kanosur të dëmtuarën se do ti shkaktojë lëndime e cyt të njëjtën që ta prek në organe gjenitale dhe tenton që të këtë marrëdhënie seksuale.

Pretendimi prokurorisë ne aktakuzë “përmes thikës duke e kanosur të dëmtuarën” e cila i referohet edhe kualifikimit juridik me nenin neni 229 par 3 nën-par 3.4 lidhur me par 1 të KPRK-së është ne tersi i pa mbështetshëm dhe nuk bazohet ne asnjë provë materiale apo edhe formale ngase vetë dëmtuara ne deklaratën e saj ne Polici me datës 02.02.2021 e ka përshkruar se “ i pandehuri i ka thënë mos bëje ndonjë gjë të marrë sepse mund të bëje keqe dhe e nxori një thik (birsk) te

xhepit nga pantallonat e tij pa e përshkruar fare se çfarë lloje të thikës, çfarë ngjyre, dhe çfarë gjatësisë.

Ndërsa në deklaratën e dhënë në mundësinë hetuese të veçante të dëmtuarës ka deklaruar se "i pandehuri e ka mbyllur derën me qelës dhe e ka nxjerr një thikë nga xhepi dhe me ka thënë se jam person i keq dhe mund të bëjë gjëra të këqija, pra edhe në këtë dëshmi të dëmtuarës nuk ka përshkruar fare se çfarë lloje të thikës, çfarë ngjyre, dhe çfarë gjatësisë.

Prandaj gjykata ka konstatuar se aktakuza e cila i referohet rrethanës kualifikuese siç është par. 3.4 i nenit 229 par. 3 është ngritur për asnjë provë materiale e po ashtu as formale duke marrë parasysh se menjëherë pas arrestimit të të pandehurit është bërë këqyrja dhe verifikimi i vendit të ngjarjes nga ana e policisë së bashku me të dëmtuarën dhe babain e të pandehurit si dëshmitar.

Mirëpo nga vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve nga e dëmtuarës A.. e datës 12.10.2020 vërtetohet se brisku (i ngjitur me qelës) është sekuestruar nga e dëmtuarës A.. dhe jo të pandehurit, me çka duke u bazuar në provat mbi të cilat është bazuar aktakuza është vërtetuar se brisk ka pasur e dëmtuarës dhe jo të pandehurit. 9 shkresat e lënës nr. 81)

Ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit F.. D.. gjykata ka vërtetuar faktin si çështje me rëndësi se natën kritike të njëjti i kishte thënë të dëmtuarës se po nisja për F.. duke e lënë vetë dhe se i njëjti nuk ishte nisur për F.., por pas 5 minutave e kishte kuptuar se e dashura e tij ishte nisur me të pandehurin për në bjeshkën e Rugovës dhe se nuk kishte arritur të komunikoj me të dëmtuarën deri sa ajo e kishte kërkuar duke e thirrur në telefonin e djalit të të pandehurit e ku me pas i kishte thënë se kam qenë e burgosur se çfarë tjetër i ka ndodhur nuk i kishte treguar e dëmtuarës. Prandaj nga dëgjimi i këtij dëshmitari gjykata ka vërtetuar faktin se: e dëmtuarës fare nuk kishte tentuar që ta thirrte dashurin e tij këtu F.. si dhe faktin se ky dëshmitar nuk kishte lajmëruar fare policinë për mos dijeninë e tij se ku e kishte të dashurën.

Prandaj nga dëgjimi i këtij dëshmitari gjykata nuk ka mundur të vërtetojë ndonjë element të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, e në aspektin e vërtetimit të këtyre elementeve gjykata dëshminë e këtij dëshmitari e vlerëson si dëshmi qartazi të pa rëndësishme ngase kemi të bëjmë me një dëshmitar sipas dëgjimit dhe atë nga ajo se çfarë i kishte thënë e dëmtuarës.

Gjykata duke vlerësuar dëshminë e të dëmtuarës A.. të njëjtës dëshmi nuk i ka falë besimin ngase e njëjta është konfuze, kontradiktore dhe jo konsistente në të gjitha fazat e procedurës penale, ngase me asnjërin as tjetrën deklaratë nuk ka arritur që në mënyrë të argumentuar dhe bindëse të përshkruaj ngjarjen nëse i pandehuri e ka sulmuar seksualisht.

Prandaj duke marrë parasysh vlerësimin e gjykatës për dëshmitarin F.. D.. gjykata ka konstatuar se aktakuza në këtë çështje penale mbështet vetëm në një deklaratë dhe atë të dëmtuarës A., e nga dëshmia e të dëmtuarës A.. nuk është vërtetuar fakti se i pandehuri i ka ndërmarrë veprimet për të cilat është akuzuar.

Ndërsa nga provat materiale të administruar në shqyrtim gjyqësor si raporti i oficerit H.. O.. #3393, i datës 12.10.2020, Raporti i policit A.. Sh.. #9016, i datës 12.10.2020 dhe Raporti i

përpiluar nga zyrtari policor S.. H.. #8975, i datës 12.10.2020 gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë element të veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri ngase te njëjta nuk kanë provuar asnjë një fakt relevant për vërtetimin e drejtë të gjendjen faktike, mirëpo te njëjtat janë raporte informuese të cilat ndermirën nga zyrtaret policor lidhur me rastet për të legjitimuar veprimet hetimore dhe përshkuar verimet.

Ndërsa gjykata duke vlerësuar mbrojtën e te akuzuarit duke e krahasuar me dëshmitë e dëshmitarit dhe me provat materiale i ka falur në tersi besimin mbrojtjes se tij e cila ka rene ndersh vetëm me dëshminë e te dëmtuarës, ngase i pandehurit ka deklaruar se e dëmtuara vetëm pasi e ka kuptuar se i dashuri i saj nuk kishte shkuar për ne F., i ka ndërmarr veprimet duke ju shmangur te pandehurit dhe paraprakisht duke ja marr veturën e tij dhe pas e ka thirr ne telefon djalin e të pandehurit, ngase ne asnjë rast e dëmtuar dhe as dëshmitari F.. nuk kanë konfirmuar se nga ora 03:00 e mëngjesit e deri sa ishin kthyer nga Rugova ne pas orës 10:30 nuk kishin komunikuar ne mes veti, apo se paku Prokuroria me asnjë provë materiale nuk i ka dëshmuar gjykatës se paku tentimin e komunikimi në mes tyre, mirëpo duke akuzuar te pandehurin për veprimet si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në tersi duke u bazuar ne teorinë e të dëmtuarës dhe pa e paraqitur asnjë provë tjetër materiale të cilat e mbështesim se paku mungesën e pëlqimit nga ane e te dëmtuarës e cila lidhet me rezistencën e saj edhe nëse do të ishte vërtetuar vepra penale, prandaj duke marr parasysh se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve te rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite te ligjit penale interpretohen ne favor te të pandehurit dhe te drejtave te tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës se Republikës se Kosovës.

8. Vendimi për lirimin e te akuzuarit nga akuza

Lidhur me pretendimet e Prokurorisë se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv te këtij aktgjykimi, gjykata pas administrimit te provave, ka vlerësuar me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet, andaj gjykata konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së te njëjtin e liroj nga akuza.

Me dispozitën ligjore te nenit 3 par. 2 te KPPRK-se është përcaktuar se: mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve te rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite te ligjit penale interpretohen ne favor te të pandehurit dhe te drejtave te tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës se Republikës se Kosovës, andaj meqenëse ne rastin konkret te gjitha provat e administruara e dëshmojnë pafajësinë e te akuzuarit, për veç deklaratës se te dëmtuarës e cila dekorata ke mbetur si prove e vetme dhe ne kundërshtim me vetveten, e ne kuptim te nenit 8 par. 1 dhe 2 te KPPRK-se gjykata vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit

Me dispozitën ligjore te nenit 257 te KPPRK-se është përcaktuar se gjykata nuk e shpall fajtor te akuzuarin duke u mbështetur vetëm ne një dëshmi.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marr duke u bazuar ne nenin 454 par. 1 të KPP-ës

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2020:137888, 29.02.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i,

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë ditëve) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.